




NEWSLETTER

Mars 2025

Nr.3

Është mbajtur takimi i parë publik i ASHMA-së për vitin 2025



Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 26 mars mbajti takimin e parë publik për këtë vit, në të cilin drejtori dr. Zoran Trajčevski bëri pasqyrim të aktiviteteve të realizuara në përputhje me Programin vjetor të punës në tremujorin e parë. Të pranishmit patën rastin të dëgjojnë për aktivitetet lidhur me zbatimin e mbikëqyrjeve administrative programore të transmetuesve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe botuesve të mediave të shkruara, si dhe masat e shqiptuara vërejtje publike për ato subjekte që kanë shkelur Ligjin për Media dhe Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Në event u përmendën aktivitetet lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe evropian, procedurat e iniciuara për heqjen e lejeve për transmetuesit, vendimet për heqjen dhe dhënien e lejeve për transmetimin e programeve, ndarjen e donacionit prej 1.500.000 denarë për viktimat e zjarrit në Kočan etj.

Prezantimi për aktivitetet e realizura në përputhje me Programin Vjetor të Punës për periudhën janar-mars 2025 është i disponueshëm në [link](#)

Ambasadori i Francës, Kristof Le Rigoler, në një vizitë pune në ASHMA



Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dr. Zoran Trajčevski, më 21 mars në ambientet e Agjencisë ka mbajtur takim pune me një delegacion të Ambasadës së Republikës së Francës, të udhëhequr nga ambasadori Kristof Le Rigoler. Në fillim të takimit, ambasadori Kristof Le Rigoler shprehu keqardhjen e thellë për viktimat e zjarrit tragjik në Kočan dhe përcolli mesazhe mgushëllimi dhe empatie të popullit francez në këto momente të vështira për qytetarët e Maqedonisë.

Në takim u diskutua për punën e rregullatorit dhe sfidat me të cilat përballlet, për zbatimin e legjislacionit maqedonas që është në përputhje me Direktivën për Shërbimet Mediatike Audiovizuale të Bashkimit Evropian dhe nevojën për harmonizimin e mëtejshëm me aktet dhe standardet evropiane, si dhe për Kodin Zgjedhor në pjesën për mediat dhe për monitorimin e përfaqësimit mediatik në zgjedhje.

Në fund të takimit, bashkëbiseduesit shprehën përkushtimin e tyre për thellimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit të përbashkët.

Njoftim publik

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 16 mars përmes njoftimi publik për media shprehën keqardhjen e thellë lidhur me tragjedinë në diskotekën në Kočan. Agjencia u bëri thirrje mediave që të jenë veçanërisht të kujdesshme në raportim në mënyrë që të respektohet dinjiteti i viktimave dhe të mos shkaktohet dhimbje shtesë për familjet e tyre. Në deklaratë theksohet se media duhet të ketë parasysh ekuilibrin mes të drejtës së publikut për t'u informuar dhe dhimbjes dhe pikëllimit personal dhe të shmangë publikimin e skenave/fotografive/videove eksplicite nga ngjarja, pra të respektojë rreptësisht standardet profesionale dhe etike. Gjatë publikimit të përmbajtjeve ato duhet të shënohen paraprakisht me paralajmërim të përshtatshëm vizual dhe/ose akustik.

Pasi Qeveria e RMV-së shpalli shtatë ditë zie në të gjithë vendin, Agjencia urdhëroi mediat që të transmetojnë/publikojnë përmbajtje që për nga funksioni i saj mediatik korrespondojnë me ditë zie. Muzika që do të transmetohet duhet të jetë nga zhanret muzikore të përshtatshme për ditë zie, transmetimi i emisioneve argëtuese, humoristike apo programeve artistike të zhanrit komedi të shtyhet për pas përfundimit të tyre dhe transmetimi i reklamave, pra të gjitha format e komunikimeve komerciale, të shtyhet deri në fund të ditëve të zisë. Gjatë kohës së ditëve të zisë, transmetuesit u liruan nga detyrimi për transmetim të një përqindje të caktuar të muzikës vendase.

Më 19 mars, Agjencia informoi se lidhur me zjarrin tragjik në Kočan, në seancën e 12-të të Këshillit të Agjencisë, është marrë vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion në vlerë të përgjithshme prej 1.500.000,00 denarë. Donacioni do të realizohet përmes Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, në llogarinë e veçantë të dedikuar - Fondi i Solidaritetit.



NEWSLETTER

Më 20 mars, Agjencia u bëri thirrje mediave që t'i përmbahen standardeve më të larta profesionale dhe etike kur raportojnë për varrimin e viktimave nga zjarri tragjik në Koçan. Në njoftim thuhet se gjatë transmetimit të informacionit, edhe përmes rrjeteve sociale, detyrimisht duhet të respektohet dhimbja dhe pikëllimi personal i familjeve, familjarëve dhe të afërmeve të të ndjerëve dhe t'u lejohet me dinjitet të përshëndeten me të afërmit e tyre. Mediat nuk duhet të publikojnë foto dhe video të varrezave, anëtarëve të afërt të familjes dhe duhet të respektojnë momentet private për të mos shtuar më tej dhimbjen e të pikëlluarve.

Më 21 mars, përmes një njoftimi publik është gjykuar ashpër gjuha e urrejtjes dhe thirrjet për dhunë ndaj mediave dhe gazetarëve. Në njoftim është theksuar se thirrjet për sulme ndaj mediave dhe punonjësve të medias kërcënojnë drejtpërdrejt sigurinë e gazetarëve dhe paraqesin sulm ndaj lirisë së shprehjes. Njëkohësisht, Agjencia sërish i përkujton mediave gjatë krijimit të programit të tyre t'i kushtojnë vëmendje të veçantë përmbajtjeve të emisioneve, filmave dhe serialeve, veçanërisht se çfarë kuptimi mund të marrin në kontekstin e këtyre momenteve të ndjeshme. Informacioni dhe përmbaja që publikohen duhet të jenë të përshtatshme për ditë zie dhe njëkohësisht të respektojnë standardet më të larta profesionale dhe etike të gazetarëve.

Pasqyrë e programeve të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara shqisore në 2025

Më 13 mars, Agjencia ka publikuar [Pasqyrë të programeve që ofruesit e shërbimeve mediatike, në përputhje me planet e tyre të veprimit, do t'i bëjnë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara shqisore gjatë vitit 2025](#). Sipas Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ofruesit e shërbimeve mediatike janë të detyruar të ndërmarrin hapa të vazhdueshëm dhe progresiv për të siguruar aksesueshmëri të shërbimeve të tyre për personat me aftësi të kufizuara. Për funksionalizimin e këtij detyrimi, është hartuar një Rregullore për aksesueshmëri në shërbimet mediatike, e miratuar nga Këshilli i Agjencisë më 13 qershor 2024, në bazë të së cilës shërbimet mediatike përkatëse kanë dorëzuar planet vjetore të veprimit për vitin 2025.

Për të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me aksesueshmërinë e shërbimeve mediatike, Agjencia ka vendosur një adresë elektronike dostapnost@avmu.mk. Kjo pikë kontakti shërben për marrjen e informacionit, paraqitjen e ankesave, dorëzimin e planeve të veprimit dhe raporteve, si dhe për shkëmbimin e informacionit përkatës.

Pasqyra e programeve që ofruesit e shërbimeve mediatike, në përputhje me planet e tyre të veprimit, do t'i bëjnë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara shqisore gjatë vitit 2025 mund të shkarkohen [në linkun](#) në vijim

Mbikëqyrja e transmetuesve dhe operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Mbikëqyrje të rregullta programore për respektimin e disa detyrimeve ligjore janë kryer mbi Nasha TV, TV 21-M, TV 24 Vesti, TV Klan Maqedoni, TV Shenja dhe TV Sonce. Mbikëqyrjet përfshinin detyrimet për përdorimin e gjuhës në programe, transmetim ditor së paku 12 orë të programeve televizive dhe transmetim ditor së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, rregullat për transmetimin e komunikimeve komerciale audiovizuale, mbrojtjen e të miturve nga programet që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral, mbrojtjen e të dhënave personale të të miturve, ofrimin e kuizeve ose formave të tjera në lojra shpërblyese, përdorimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik, transmetim i lojërave të fatit. Me mbikëqyrjet janë konstatuar disa shkelje nga transmetuesit për dispozita të ndryshme të LSHMAAV. Në programin Nasha TV të transmetuar më 4 mars, në edicionet premierë dhe të ritransmetuara "Proekt zdravje"(Projekti shëndet), "Gradime da trae"(Ndërtojmë të qëndrojmë) dhe "Zgotveno nad oblaci"(Gatuar mbi re), u transmetuan pop-ap/reklama në ekran të ndarë ndërmjet të cilave nuk kalon periudha e parashikuar prej së paku 15 minutash.

Në programin e TV 21-M të transmetuar më 4 mars në edicionin premierë të emisionit "Thirre 21-shin (Povikaj go 21)" janë konstatuar tre shkelje - janë transmetuar pop-ap/reklama në ekran të ndarë ndërmjet të cilëve nuk ka kaluar periudha prej së paku 15 minutash, është transmetuar komunikim i fshehur komercial audiovizual për "Optika Kapri" dhe nuk janë respektuar detyrimet gjatë organizimit të programeve me pjesëmarrje në lojra shpërblyese. Në programet e TV 24 Vesti të transmetuar më 4 mars, në emisionin e specializuar informativ "Faktor Zdravje me Biljana Debarlieva", nuk janë respektuar kushtet për plasimin e produktit në programet audiovizuale, si dhe rregullat për shënjimin e programeve që përmbajnë plasim të produkteve, ndërsa në programin e TV Klan Maqedoni transmetuar më 4 mars, episodet e serialeve "Majka"(Nënë), "Merjem" dhe "Neverstvo" (Tradhëti), të cilat janë shënuar si programe të kategorisë së tretë (12+) janë transmetuar në kohë të papërshtatshme nga shërbimi programor.



NEWSLETTER

TV Klan Maqedoni dhe TV Shenja në programet e tyre të transmetuara më 5 mars nuk kanë transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, dhe as së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, të transmetuar në periudhën prej orës 7:00 deri në orën 19:00. Vetëm tek TV Sonce nuk është konstatuar shkelje të dispozitave ligjore.

Në të njëjtat televizione është bërë mbikëqyrje e rregullt administrative lidhur me detyrimet për publikim impresium, informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve dhe detyrimin për publikimin e identifikimit të transmetuesit. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar shkelje tek TV 21-M, TV Klan Maqedoni dhe TV Shenja. TV 21-M nuk i publikoi të dhënat për impresium në emisionet "#21 Reportazhe" dhe "Për ditë të mbarë"; TV Klan Maqedoni nuk ka publikuar të dhëna për impresium në emisionet edukative me përmbajtje fetare me rastin e Ramazanit "Merr Frymë" (Dishi) dhe "Në 'konak te Hoxha" (Vo konakot na Oжkata) dhe emisionin aktual-informativ "Klan debat", si dhe informacionet që duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve. Shenja TV nuk i publikoi të dhënat për impresium në programin dokumentar "Al Jazeera Hulumton (Al Jazeera – Investigations)".

Është kryer dhe një mbikëqyrje e kontrollit programor mbi TV Spektra, për të përcaktuar nëse transmetuesi ka vepruar sipas masave të shqiptuara vërejtje publike, drejtuar për mos respektim të detyrimit për transmetim të programit në gjuhën maqedonase dhe alfabetin kirilik dhe mostransmetim të së paku 30% program ditor të krijuar burimisht si vepra audio apo audiovizuele maqedonase. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se televizioni nuk ka vepruar sipas masës vërejtje publike, përkatësisht në programin e transmetuar më 20 shkurt nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Sipas detyrës zyrtare, është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore mbi punën e Radios Universitare Radio UGD FM për të konstatuar nëse transmetuesi e zbaton konceptin programor për të cilin është dhënë leja për veprimtari transmetuese. Me mbikëqyrjen e jashtëzakonshme u konstatua se transmetuesi në programin e transmetuar në periudhën prej 10 deri më 16 shkurt nuk ka zbatuar së paku 80% të konceptit programor për të cilin është dhënë leja për veprimtari transmetimi.

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullta programore mbi operatorët Viva Net, Kabel-L-Net, Makedonski Telekom, Neotel, Telenet Kom dhe Infel-KTV për detyrimin në pakon programore që ritransmetojnë detyrimisht dhe papagesë të ofrojnë shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe detyrimin për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimin e programeve që ata ritransmetojnë. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje.

